Edicioni numër 12. Maj 2014.

# Q MAGAZINE

## Diskriminimi në Kosovë dhe në gjithë botën kundër komunitetit LGBT




- LGBT dhe Religjioni FAQE. 3
- Islanda e Bukur FAQE. 7
- Pamjet dhe Stereotipet FAQE. 15

# Diskriminimi në hapësirat publike në Kosovë



Në Kosovë ka një nivel shumë të lartë paragjykimi,diskriminimi dhe jo tolerance ndaj komunitetit LGBT,pra thënë ndryshe janë homofobë dhe transfobë. Duhet të kemi parasysh se respektimi i lirive të njeriut nënkupton respektimin e mendimit dhe të shprehjes së lirë, qoftëedhe të atyre ideve që mund të konsiderohen nga shumica si shprehje e injorancës apo prapambetjes. Grupe protestueskundër komunitetit LGBT (ndoshta jo ndaj një personi të caktuar por ndaj "fenomenit")ekzistojnë kudo, si shembull mund të parmendën grupe fetare fundamentaliste tështeteve të ndryshme,ku grupe të tilla lejohet te shprehin bindjet e tyre "homofobike" lirshëm, sa për ilustrim filmi i fundit i Sasha Baron Cohen (i cili u bë i njohur me personazhin Borat)që titullohet Bruno,bënë fjalë pikërisht për këtë,Cohennëpërmjet personazhit të homoseksualit Bruno,përdorsarkazëm për të demaskuar në mënyrë gjeniale homofobin, diskriminimin që ekziston sot në botë. Ne shohimtë domosdoshëm trajtimin e kësaj teme nga mediat,gjë që do tëmundësonte në një far mënyre "edukimin"e shoqërisë,pranimin e komunitetit LGBT pikërisht nëpërmjet paraqitjes së absurdit që ekziston në ndërgjegjen e homofobit.Sjellja homofobikeapo transfobikedhe fyerjet publike ndaj një anëtari të komunitetit LGBT janë akte kriminale ndaj të cilit duhet të reagojë jo vetëm moralisht shoqëria,por edhe ligjërisht shteti i së drejtës,ato janë shkelje e parimeve bazë kushtetuese, tëtë drejtave të njeriut. Ta cekim pak ditë më parë në një nga lokalet e Prishtinës ka ndodhur një shkelje e tëdrejtavetë komunitetit LGBT duke i nxjerrë nga lokali të përcjellë me fyerje dhe kërcënime. Dhe njëkohësisht duke bërë thirrje për ndalimine hyrjes së femrave me flokë të shkurta, dhe personave që në dukjen të jashtme kishin tipare të kundërt me seksin e tyre,kjo është një shkelje e rënd e komunitetit LGBT dhe diskriminim i drejtpërdrejt i qasjes në vende publike. Janë marr masa të menjëhershme nga QESh në lidhje me këtë rast dhe shpresojmë që me këtë kemi ulur sa do pak diskriminim dhe shkeljen e të drejtave të komunitetit LGBT . Shpresojmë në ngritjen e nivelit të vetëdijesimit të shoqërisë Kosovare në raport me komunitetit LGBT. Marrë parasysh që ne komunitetin heteroseksual i pranojmë ashtu si janë pa paragjykim për pamjen e tyre, apo gjestet e tyre, kërkojmë edhe nga ata të na pranojnë neve (komunitetit LGBT) pa paragjykime, po as gjykime dhe të na respektojnë për atë që jemi.Prandaj gjithkujt që kërkon ti mbrojë ato vlera të cilat na u dhunuan aq egërsisht, siç janë liria për të qenë vetja jonë,për të shprehur mendimin ndryshe duhet ti dalë në mbrojtje kauzës tonë.Gjithkush duhet të thotë me zë te lartë "jamgej", "jam lesbike", "jam biseksual, "jam transgjinor" për ti bërë ballë kësaj shoqërie barbare sa nuk është vonë,dhe kush mendon se kjo barbari kërcënon vetëm komunitetin LGBT me të cilët ai s'ka të bëjë, gabohet shumë,ajo është një kërcenim për lirinë e kujtdo në Kosovë.

**nga: L, D & K.**



# LGBT dhe Religjioni



Unë nuk jam fetar, jo nuk praktikoj asnjë fe, pse të praktikoj një fe që më dënon. Këto janë disa nga përgjigjet që zakonisht një anëtar i komunitetit LGBT i jep nëse bëhet pyetja për Religjionin. Pse ndodh kjo? A janë vërtet Personat LGBT të pafe? Apo janë siçi përshkruajnë personat religjioz, të paskrupullt që nuk i dinë limitet etike të asnjë gjëje? Epo as kjo nuk e besoj qëështë e vërtetë. Personat LGBT janë si gjithë personat tjerë në gjithë botën, Mysliman, Katolik, Ortodoks, të pa fe, Ateist etj. Në Kosovë ku 95.6% e popullsisë janë Mysliman medoemos edhe shumica e personave LGBT do të jenë të fesë Islame. Arsyeja pse personat LGBT ndoshta janë më pak Religjioz, vjen prej faktit që Feja Islame ashtu si e mësojmë ne i mohon dhe dënon personat LGBT me dënime shumë të ashpra. Pastaj, ndodhitë e fundit që kanë ndodhur në Kosovë dhe predikimet e predikuesve fetar janë disa nga faktorët që kanë ndikuar qëpersonat e komunitetit LGBT të largohen nga religjioni. Është më se e dukshme që zëri më i dëgjuar kundër komunitetit LGBT janë predikuesit fetar. Janë ata që thërrasin për dhunë, gjuhë të urrejtjes, kërcënime etj.Megjithëse në Ligjet e Kosovës gjuha e urrejtjes dënohet, ata prapë vazhdojnë me ato të vetat sikur thua se fituan Xhenetin me atë që po bëjnë, dhe në këtë rreth personat që dalin humbës janë komuniteti LGBT.Për më tepër religjioni në Kosovën e pasluftës është organi më i madh për gjuhë të urrejtjes dhe shumica e popullatës jo që e praktikojnë fenë, por pasi qëkur ishin fëmijë këtë fe ia mësuan e kjo fe iu ka mbetur, e dëgjojnë dhe e besojnë çdo gjë që ju thotë një "hoxhë". Nëse i shihni disa video nëYoutubedhe predikimet e bëra nga "Hoxhallarët" Ezani(Ejani në namaz, Ejani në shpëtim) ndoshta duhet të ndryshohet, në"ejani në predikim për dhunën", "ejani tu tregojmë se kush duhet të vdes". Dhe ata Hoxhallarë që nuk shprehnin mjaftueshëm gjuhë të urrejtjes,siç është rasti i një hoxhe që ishte të paktën gati që të bisedonte për problemet e komunitetit LGBTlargohet për shkak të mendimeve të tij "shumëliberale".Pse të shkoj dikush të falet në atë xhami? Që t'ia mbush zemrën me urrejtje? Që të iu thonë që këtë duhet vrarë ose atë duhet vrarë? Nuk mund të them që e di Kur'an-in përmendsh por e di qëKur'ani nuk bën thirrje për dhune, përkundrazi bën thirrje për Paqe.Në fund të fundit kush ka të drejt të vendos se çkaështë e drejt apo e gabuar kur ka të bëj me ndjenjat tona?Kur falemi përshembull ne flasim me Zotin, dhe kjo është një bisedë e njëanshme sepse deri më sot askujt nuk i ka kthyer Zoti përgjigje, pra ne dëgjojmë vetëm përgjigjet që i marrim nga familjarët, shoqëria, rrethi, predikuesit etj. dhe këto përgjigje pastaj prapë varen nga interesat e palës së tretë, që jo gjithmonë mund të jenë të sakta. Unë besoj qëështë një Zot që ka krijuar gjithçka, dhe që ka krijuar edhe personat LGBT, dhe pastaj unë besoj që një Zot i mirë, i dashur, pafundësisht i urtë, nuk do të krijonte personat LGBT dhe të priste që të jetonin jetët e tyre të palumtur, të vetmuar e të shtypur, dhe nuk besoj që do tëpriste nga ta që të jetonin jetët e tyre në mohim, duke mohuar veten e tyre, që të pranoheshin nga Ai, e të toleroheshin nga njerëzit, por do ti donte si të gjitha krijesat tjera të Tij. Mënyra se si duhet të shikohet religjioni nga personat LGBT është ndoshta e gabuar. Religjioni nuk ka të bëj me njerëzit por ka të bëj me Zotin, andaj mos u bazoni se çfarë thonë njerëzit, por bëjeni lidhjen tuaj me Zotin në mënyrën tuaj.

Nëse predikuesit fetar edhe pse nuk do të pranonin komunitetin LGBT të paktën të mos bënin thirrje për urrejtje dhe dhunë,dhe organet e rendit dhe të sigurisë të bënin më shumë qëtëpërndjekin personat që bëjnë këto krime, tëimplementonin ligjet që ndalon thirrjet për urrejtje dhe dhunë atëherë një vend më i mirë dhe më i sigurt do të mund të krijohej për personat LGBT në Kosovë. Dhe pse jo në të ardhmen të hapej njëXhami me Imam që predikon fenë dhe nuk gjykon, dënon dhe urren komunitetin LGBT, por i pranon ashtu siç janë dhe u mëson që feja i pranon edhe personat e këtij komuniteti, siç edhe ka ndodh në shtetet perëndimore.

**nga: Pinky Man**

# Lufta kundër gjuhës të urrejtjes



Në një shtet si Kosova ku idetë lëvizin shpejtë, të gjithë mund të shohim ndikimin e globalizimit në te. Jetën e disave janë bërë më të mira, ndërsa për të tjerët, stili i tyre i jetesës vazhdon të jetë betejë. Me siguri, popullata jonë, tani posedon më shumë dituri për botën dhe larminë unike brenda kulturës sonë, por prapë se prapë disa nga këto dallime nuk pranohen ende në kulturën tonë.

Në kulturën tonë, njerëz LGBT kanë ekzistuar përgjithmonë, sikurse në kultura tjera. Faktikisht, në kohën e bejlerëve, njerëzit Gej – "dylberët" vlerësoheshin lartë, dhe njerëzit më të pasur kishin të dashurit e tyre mashkullorë. Kemi edhe shumë këngë që i përshkruajnë këto marrëdhënie. Në anën tjetër e kemi rastin tek Burrneshat ose virgjëreshat e betuara – tënjëjta me meshkujt transeksual të sodit- të cilat vlerësoheshin lartë. Këto pikëpamje na jepin një botëkuptim se sa e hapur është apo ishte kultura Shqiptare.

Megjithatë, në kulturën tonë moderne, shoqëria LGBT në Kosovë, edhe pse më vizibile se përpara, merr një konotacion negativ nga shumica e popullatës. Ka pasur shumë sulme ndaj kësaj shoqërie, e madje edhe disa vrasje.

Edhe pse qeveria jonë e përkrah komunitetin LGBT, veçanërisht për shkak të presionit nga organizatat ndërkombëtare, urrejtja ende vazhdon, madje është ka shtohet.

Ky artikull nuk është aq shumë për atë se çka përjeton komuniteti LGBT në Kosovë. Nëse jeni duke e lexuar këtë revistë, ju me siguri i njihni stigmat që ekzistojnë ndaj komunitetit LGBT dhe urrejtjen me të cilën ata ballafaqohen çdo ditë; sidoqoftë ky shkrim merret me atë se çka duhet të bëhet në Kosovë për t'ju garantuar të gjithë njerëzve një vend të sigurt për jetesë. Cilët hapa duhet të ndërmerren që të jemi tësigurte që Kosova është duke shkuar drejt demokracisë; që shteti jonë mos tështdërrohet në një vend urrejtjeje dhe torture për grupet minoritare.

Qeverisë sonë i mungon definim konkret i ligjeve; për t'ju dhënë të gjithënjerëzve të drejtat e barabarta që iu përkasin; dhe për tu siguruar se ligjet implementohen. Për më shumë, qeveria jonë nuk na siguron që shprehja e urrejtjes ndalohet por edhe kur ndodhë, paralizohet.

Për shembull, kemi shumë udhëheqës fetarë të cilët turpërojnë publikisht njerëzit LGBT; kanë thënë edhe që këta njerëz duhet të vriten apo të vendosen në institucione mentale. Një njeri mund të thotë që njerëzit si Irfan Hoxha nuk duhet të merren seriozisht; por kur ec rrugës në Kosovë, ne mund të shohim se sa ndikim ka feja në shoqërinë tonë, sidomos në një sekt qëështë më ekstrem dhe që shpreh urrejtje ndaj atyre që nuk e jetojnë tënjëjtin stil të jetës si ata.

Para luftës të 1999-tës, hera e parë që e pashë një femër të mbuluar ishte ne Amerikë, njëjtë me njerëzit me mjekra të rritura dhe pantolla tëshkurtër, por 15 vjet më vonë, është mrekulli nëse nuk e sheh ndonjë në rrugët e Kosovës.

Sigurisht qëçdokush duhet ta ketë të drejtën e shprehjes dhe fjalës së lirë; pas së gjithave shumënjerëz kanë dhënëjetën e tyre që ne të kemi të drejtën të shprehemi lirisht. Por a nuk duhet liria e shprehjes të ketë një kufi? Nëse rrezikon jetën e njerëzve, a vazhdon të jetë liri e shprehjes apo thjeshtë shprehje e urrejtjes?

Më 1989, diktatori Sllobodan Milosevique dha fjalimin e tij të famshëm në Gazimestan. Në këtë fjalim, i cili ishte i bazuar në Memorandumin e 1986-tës të Akademisë së Shkencave të Serbisë, si vazhdimësi e memorandumeve urrejtëse të Grashaninit me 1844 dhe Cubrilloviqit me 1937, Milloshevigi i shpreh mendimet urrejtëse ndaj Shqiptarëve, dhe në këtë mënyrë e përforcoi një fobi ndaj një grupi të tërë etnik. Ky fjalim ishte fillimi i një gjenocidi eventual sepse shpejt pas tij ekstremistët Serb e zëvendësuan urrejtjen e tyre verbale në urrejtje fizike, urrejtje e cila shtyu deri te vrasja, masakrimi dhe dhunimi i shumë shqiptarëve nga Kosova. Hamendem nëse fjalimet urrejtëse, si ato të disa udhëheqësve fetarë, nuk ndalohen, do të na shtyjnë drejt një gjenocidi eventual ndaj një komuniteti të caktuar në Kosovë përsëri? A jemi ne një shoqëri e cila si ish-viktimë, tani i viktimizon të tjerët?

Arsyeja pse po e bëj këtë krahasim është sepse krejt urrejtja është e njëjtë; dallimi ndërmjet viktimës dhe abuzuesitështë shumë i vogël. Sot, tënjëjtit njerëz që me forcë u larguan nga Kosova, të cilët ishin dëshmitarë ndaj dhunimeve dhe vrasjeve, tani shprehin urrejtje ndaj grupeve tënjerëzve që janë të ndryshëm nga ata. Faktikisht, disa shkojnë aq larg sa që të shprehen se donë ta eliminojnë komunitetin LGBT, donë ti vrasin apo ti vendosin në institucione mentale. Kjo shpesh çon drejt migrimit apo izolimit.

Qeveria e Kosovës ka dështuar në identifikimin dhe penalizmin e shprehjes së urrejtjes. Shpesh, e mbyll derën ndaj grupeve minoritare dhe i len ato në rrezik. Shprehja e urrejtjes mund tështdërrohet shumë lehtë në ndëshkim fizik dhe ekzekutim tënjerëzve. Kur analizojmë barbarizmat më të mëdha në histori, është lehtë të identifikojmë propagandën që u përdor. Për të praktikuar demokraci dhe liri të vërtetë në këtë shtet, duhet që liritë e të gjithëve mbrohen; që çfarëdo lloj urrejtje e shprehur ndaj çfarëdo grupe njerëzish të ndëshkohet. Përndryshe Kosova do të shndërrohet në një "shtet të dështuar" dhe një kauze e dështuar në emër të demokracisë.

Lufta në Kosovë ende nuk ka përfunduar. Puna më e madhe bëhet nga një shoqëri e shëndoshë me përkrahjen e një qeverie të shëndoshë.

Lufto popull luftarak, sepse pa luftë je i humbur!

**nga: Blerta Avdili**



# Peder, Pederas, Homoseksual...



Ne të gjithëve na u kanë bërë të zakonshme këto fjalë, njëjtë sikur fjala "zezak" që vazhdon të kujtoj komunitetin Afrikan Amerikan në SHBA rreth të kaluarës së tyre të shëmtuar, dhe që ende vazhdon të minimizoj dhe depersonalizojnë personat që i përkasin Afrikës. Por, ne a i kushtojmë vëmendje stigmës që vijnë me këto fjalë? Sa shumë këto fjalë me të vërtetë depersonalizojnë personat? Si këto fjalë kthejnë personin në shoqëri nga subjekt në objekt? Megjithatë, ne i përdorim të gjitha këto fjalë në gjuhën tonë të përditshme, dhe për më tepër mediat në Kosovë hezitojnë për të i ndryshuar fjalët që ata përdorin.

Dikush mund të thotë po ne kështu jemi mësuar. Që komuniteti LGBT në Kosovë ka probleme më të mëdha me të cilat përballen, nuk mund të përqendrohemi në gjuhën e përdorur. Megjithatë, duke jetuar në epokën e teknologjisë fjalët kanë rëndësi; ajo që shohim dhe dëgjojmë me të vërtetë ndikon në mënyrën se si ne e perceptojnë botën tonë. Gjatë rritjes së një të riu kur ai dëgjoi fjalën Peder, ajo është përdorur si një konotacion negativ: "nanën e pederit" ta qifsha pederin e nanes; si Peder po dukesh; Kështu që unë u rrita duke menduar se Peder është gjëja më e keqe që mund të jetë.

Në fakt, deri sa unë nuk kam arritur në një moshë për të kuptuar seksualitetin dhe takoj njerëz nga komunitetit LGBT, kam pritur "pederat ose Pederas" të duken ndryshe nga ne, me dy kokë, tri duar, ose gjithsesi të kenë një çrregullim mendor apo fizik.

Njëjteedhe fjala "homoseksual"; e cila më dha një kuptim mjekësore; në faktajo më dha një perspektivë çnjerëzore të asaj që ajo në të vërtetë është. Që individët LGBTIQ janë vetëm si çdo individ tjetër në shoqërinë tonë; prapë të ndryshme në mënyra të ndryshme ashtu siç janë të gjithë individët në shoqëri. Për shembull mua më pëlqen karotapërderisa njerëzve tjerë nuk ju pëlqen, shtrohet pyetja a duhet të kemi një term medicinal për këtë? Ose fakti që më pëlqen të ha qepë aështëë ngjashme më të qenit peder? Nëse termet krijohen për të treguar individualitetin dhe veçantit e dikujt sidomos ato negative, jam e sigurt që do të ndjehesha e çnjerëzuar. E edhe kur vërtetohet që nuk është sëmundje, këto terme do të vazhdohen të përdoren nga media sa herë që flasin për mua

Kjo është ajo që mediat në Kosovë janë duke bërë; ata janë duke u siguruar që fjalët janë në rregull për t'u përdorur pavarësisht se sa dëm i bënë dikujt! "Homoseksualiteti" ka kohë që janë provuar të mos jetë sëmundje dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë në çdo shoqëri; por nga propagandat nga grupe të urrejtjes; shumë njerëz, veçanërisht në shoqërinë tonë vazhdojnë të besojnë se kjo është një sëmundje dhe se ajo duhet të penalizohet.

Kur mediat vazhdojnë të përdorin këto fjalë, ata në mënyrë të tërthortë janëduke thënë se urrejtja kundër këtij grupi të margjinalizuar është në rregull. Siç u tha më lart, sot, ne jetojmë të rrethuar nga teknologjia, dhe ka shumë mënyra për të gjetur se cilat fjalë janë të përshtatshme kur iu referohet grupeve të margjinalizuara.

Kur mediat zgjedhin të përdorin fjalë të tilla si 'Peder' dhe 'homoseksual', sidomos nëpërkthimin e filmave, janë duke çnjerëzuar komunitetit LGBT. Në shumë mënyra, ata janë duke prodhuar gjuhë të urrejtjes sepse fjalët që ata përdorin kanë konotacion negativ.

Çka mediat në Kosovë duhet të bëjnë sepse është obligim i tyre, është që të sigurohet që fjalët e duhura përdoren kur ju referohen një grupi të caktuar. Kur injorohen shprehjet e duhura, ata injorojnëdrejtpërdrejt vlerën e njerëzve.

Për më tepër kur, mediat nuk përdorin fjalët adekuate, tregojnë jo profesionalizimin e tyre.

Shpresoj që një ditë në Kosovë do të heqim dorë nga termet degraduese në jetën e përditshme, por derisa ajo të ndodh në mënyrë që të krijohet një shoqëri më e shëndetshme, ne duhet të respektojmë grupet e margjinalizuara dhe duhet të kujdesemi se si i prezantojmë ata.

**nga: Blerta Avdili**



# Islanda e Bukur



Islanda, vendi ku mirëpriten gejët, lesbiket dhe biseksualët, vendi i cili ka pasur njëlesbike si kryeministër, dhe është vlerësuar në Diva Magazine, Gay Bare dhe klube që janë shumë të njohura; Lidhjet mes personave me të njëjtit seks janë të barabartë si lidhjet heteroseksuale në sytë e qeverisë, dhe për këtë arsye, Islanda është një nga shtetet e pakta në botë që lejon çiftet e të njëjtit seks të martohen. Për komunitetet LGBT në vende të tilla si Kosova; Revanda, India apo Rusia, Islanda mund të paraqitet si vendi ëndërr; tokë e lirisë së shprehjes dhe lumturisë.

"Po, kjo është zakonisht si është portretizuar dhe mënyra si njerëzit mendojnëpër Islandën.

Por kjo është gjithashtu një pjesë e problemit: publiku i gjerë sheh Islandën si të përsosur, dhe refuzojnë të besojnë se nuk është aq perfektë në të gjitha aspektet.

Natyrisht Islanda është më mirë se shumë vende të tjera, por edhe ata ende nuk i kanë disa gjëra.Sidomos kur është fjala për trans, queer dhe çështjet e interseksit. "-Ugla Stefania Jonsdottir

Si shumë prej nesh e dinë , gjërat mund të paraqitet ndryshe nga jashtë , dhe vetëm për shkak se shumica nga komuniteti LGB në Islandë me të vërtetë mund të jetojnë lirisht jetën e tyre , kjo nuk do të thotë që është e vërtet edhe për T-ëtindividëve trans në Islandë . Në intervistë me aktivisten e mahnitshme LGBT nga Islanda Ugla Stefania Jonsdottir , e pyeta nëse Islanda ishte me të vërtetë e mahnitshme sic është portretizuar në lidhje me të drejtat e LGBT . Ajo e pranoi se Islanda është shumë më mirë se shumë vende në botë në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBT; megjithatë, njerëzit trans në Islandë vazhdojnë ende të diskriminohen, ajo foli për shumë raste të njerëzve trans duke u sulmuar në klube, bare dhe në rrugë. Aq më tepër, librat në shkolla tentojnë të përfaqësojnë njerëz trans në mënyrë të gabuar dhe poashtu ata janë portretizuar në mënyra të papërshtatshme në media . Ligjet në Islandë janë të mrekullueshme në krahasim me shumë vende; megjithatë ligjet vazhdojnë të kenë hapësirë të mjaftueshme për të lejuar diskriminimin ndaj individëve trans të cilët përballën me diskriminin në shkolla, vendin e tyre të punës, media dhe në publik. Kur u pyet ajo për të dhënë një shembull të veçantë në mënyrën se si ligjet dështojnë për të mbështetur individët trans Ulga deklaroi se për shembull , se një grua trans ju është thënë se nuk mund të përdorinbanjone femrave në vendin e punës së saj, ajo nuk mund të padit kompanin ku ajo punon për diskriminim në bazë të identitetit gjinor. Kjo vetëm tregon se edhe pse në shumë vende rreth botës komuniteti LGBT është më e lirë të shprehin veten e tyre dhe të jetojnë jetën e tyre të lirë nga frika, madje edhe në vende të tilla si Island , njerëzit trans ende ballafaqohen me diskriminim dhe nuk trajtohen në mënyrë të barabartë si të gjitha qeniet e tjera njerëzore.

**nga: Blerta Avdili**

# Rregullat e pashkruara në vend të ligjeve apo rregulloreve






Që nga 29 mars 2014, të burgosurit trans në Turqi kanë qenë në një grevë urie për 29 ditë.

Nevojat e të burgosurve Trans dhe të burgosurit e tjerë LGB në Turqi nuk janë të pakta. Ata përballen me diskriminim, dhunë dhe izolim. Shumë prej tyre kanë përjetuar mjaft dhe kanë vendosur të bëjnë grevë urie.

Artikulli më poshtë, (botuar në http://lgbtineësturkey.com )jep më shumë detaje se me çkakëta individë po përballen dhe çka kërkojnënga qeveria turke për të bërë që të realizohen të drejtat e tyre.

Shoqëria civile në Fondacionin e Sistemit Penal (CISST) solli vëmendjen për izolimin e imponuar mbi të burgosurit LGBT. Ata deklaruan se nuk ekziston një legjislacion i tillë për këtë çështje por që administratat e Burgjeve "aplikojnë rregullat e pashkruara."CISST ka lëshuar raportin e tyre për projektin e të burgosurve me nevoja të veçanta dhe ka deklaruar se problemi kryesor më të cilin të burgosurit LGBT përballen është izolimi.

Ata deklaruan se duhet të hartohet legjislacioni për të burgosur LGBT por theksuan që krijimi i një burgu tëveçanta do të shkaktojë më shumë diskriminim dhe etiketimin.

CISST i përbërë nga një akademik, një jurist, përfaqësues të LISTAG, SPoD LGBT, dhe Lambdaistanbul.vizitoi MaltepeNr: 6 Institucioni Penal i LlojittëMbyllur ku 11 gra trans janë të burgosura.

Mustafa Eren deklaroi se problemet vërehennë çastin e hyrjes në burg. Tri femrave në mesin e vizitorëve u tha për të hequr brusat e tyre për të hyrë në burgun që sugjeron që trajtimi i të burgosurve mund të jetë shumë më keq se trajtimin e vizitorëve.Eren deklaroj se leja e vizitave nga Ministria e Drejtësisë nuk ka përfshirë vizita në repartet apo bisedimet me të burgosurit. Eren pyeti një nga nën-drejtuesit e burgut në qoftë se ata kishin legjislacion lidhur me të burgosurit LGBT dhe përgjigjja ishte , "Nuk ka legjislacion në lidhje me këtë temë. Në botë ka rregulla të pashkruara, si dhe rregulla të shkruara. Ka rregulla të pashkruara në lidhje me këtë temë dhe administratat zbaton këto rregulla të pashkruara. "

Aplikimi i rregullave të pashkruara dhe mungesa e përgjegjësisë do të thotë se rregullat janë të përcaktuara nga administratorët e burgut dhe me idenë "Unë do të bëj atë që dua."

Eren pas diskutimit ka vlerësuar që situata e të burgosurve LGBT është:

"Administrata e burgut deklaroi se 11 të burgosur janë mbajtur në 3-4 reparte. Mbajtja e 11 të burgosurit në 3-4 reparte do të thotë se ata janë mbajtur në grupe prej 2-3 njerëzve. Kjo vërteton pretendimet e izolimit (Izolimi në grupe të vogla). "

"Ndonjëherë vetë të burgosurit LGBT nuk duan të jenë të vënë së bashku me të burgosurit e tjerë për të ruajtur sigurinë e jetës së tyre. Megjithatë, administrata e burgut ata duhet të gjejnë një mënyrë për të i përfshirë të burgosurit në jetën shoqërore."

Eren diskutoj gjithashtu planin e Ministrisë të Drejtësisë për të ndërtuar një burg tëveçantë për LGBT duke thënë: "Një burg LGBT do të thotë që edhe vizitorët e këtij burgu do të etiketohen si pjesëtar të komunitetit LGBT.Nuk është zgjidhje vendosja e të gjithë të burgosurve LGBT në një burg, por duhet të zgjidhen problemet ekzistuese në burgjet e ndryshme.

Një prej vizitorëve, vullnetar ElifAvcinga LambdaIstanbul, deklaroi se të burgosurit LGBT jetojnë sipas vendimeve të administratorëve të burgut. Administratorët pohojnë se nevojat e të burgosurve LGBT janë të plotësuara por, Avxhi tha nuk mendoj se kjo është e vërtet.

Avxhi gjithashtu deklaroi se njerëzit LGBT që vizitojnë miqtë e tyre në burg janë edhe verbalisht dhe seksualisht të ngacmuar.

CISST ka listuar masat e nevojshme që duhet tëndërmerrenpër t'i dhënë fund izolimit të burgosurit LGBT:

1) **Punonjësit e burgjeve** dhe të burgosurit duhet të jenë të kenë qasje në edukim më qëllim tëçrrënjosjes tëqëndrimeve diskriminuese. Organizatat LGBT duhet të inkurajohen për të mbajtur punëtori në burgje, të cilat për qëllim duhet të kenë adaptimin social tëtë burgosurve LGBT.

2) **Zonat e kufizuara** të përbashkëta duhet të rriten. Shqetësimet e sigurisë të burgosur LGBT duhet të adresohen dhe pjesëmarrja e tyre në seminare dhe punëtori të përbashkëta me të burgosurit tjerëështë e domosdoshme.

3) **Kur zonat e përbashkëta** janë të pamjaftueshme, duhet të sigurohet që të burgosurit të kenë qasja në ato ekzistuese, dhe të përzgjedhin profesionet e tyre sipas dëshirës.

Në këtë mënyrë, Jeta në burg brenda burgut duhet të ndalohet.

# Duke Luftuar Vetëm Për Të Mbijetuar




Imagjinoni pas shumë vitesh keni qenë të varfër dhe të pastrehë duke luftuar vetëm për të mbijetuar, në fund keni diplomua, keni gjetur një punë , keni marrë banesën tuaj, dhe keni filluar t'a jetoni jetën tuaj të lumtur si ju keni kërkuar gjithmonë. Deri në një natë vonë duke ecur në shtëpi me një grup miqsh një grup të huaj të dehur fillon të fishkëllejnë dhe të bërtasin sharje raciste, homofobike, dhe transfobike për asnjë arsye. Së shpejti ata fillojnë fizikisht të jusulmojnë, të ju hedhin në tokë dhe të rrahin derisa ju jeni pa ndjenja dhe përtej njohjes. Pasi ju vënë në koma për disa ditë ju kuptoni që mikujuaj apo edhe veten është i vdekur. Tani imagjinoni se e gjithë kjo u zhvillua para një stacioni policor në një qytet miqësor të komunitetit «LGBT". Sulmuesi, edhe ai u dorëzua në polici vetëm për të u lëshuar duke paguar 1500 Euro. I akuzuar me vetëm një krim të vogël të sulmit, së shpejti të gjitha akuzat kundër tij do të hiqen. Ai do të jetë një njeri i lirë, ndërsa ju ende qëndroni i vdekur në varrin tënd.

Për 21 vjeçen IslanNettels kjo është se si përfundoi jeta e saj më 17 gusht 2013 në New York City.

23 vjeçja CeCeMcDonald përballet me një situatë të ngjashme në Mineapolis, Minesota në natën e 5 qershorit 2011. Për fat të mirë CeCe është ende gjallë dhe me ne sot, por vetëm pasi u detyrua të paguajnë $ 6410 në rikthim të sulmuesit të saj, të pranojë një ujdie, dhe u dënua me 41 muaj burg. Sulmi i Cece ndodhi kur ajo po kalonte afër një bari, kur një grup i sulmuesve thërritën sharje të ngjashmekundër saj dhe miqve të saj, dhe më pas një shishe u thye në të gjithë fytyrën e Cece dhe një luftë shpërtheu. Ajo përfundimisht do të mbrojë jetën e saj me një palë gërshërë që ajo kishte në çantën e saj, në fund të fundit duke i dhënë fund jetës të sulmuesit të saj dhe duke qenë i vetmi iarrestuar atë natë. Sulmuesi i saj kryesor ishte i dehur dhe në ndikim të substancave të shumta, kishte një tatuazh kryqi të kthyer në gjoksin e tij dhe dënime të shumta të mëparshme për sulm. Gjyqtari gjatë gjykimit të Cece-së hodhi poshtë të gjithë këtë, ende duke pretenduar se sulmi i saj nuk kishte asnjë paragjykim dhe ajo nuk ishte duke mbrojtur veten, duke çuar në bindjen e saj për vrasje të shkallës së dytë, pasi ajo pranoi një ujdi të pranimit të fajit për t'u paraqitur fajtore dhe për të zvogëluar përgjegjësinë e saj nga vrasja e shkallës së dytë natyrisht.

Në fund jeta eIslanNettels u pre përgjysmëdhe McDonald u ndëshkua ligjërisht sepse i kishte mbijetuar një sulmitransfobik. Çuditërisht Legjislacioni në Minnesota mbron individët trans, por vendimi i gjyqtarit se sulmi nuk kishte asnjë paragjykim, racore, identitetit gjinor, apo orientimin seksual, nuk arriti të mbrojë Cece. Ndërsa për Islan Nettels, New York nuk ka ndonjë legjislacion të krimit të urrejtjes në mbrojtjen e individëve trans. Pavarësisht qëBarakObama bëri miratimin e legjislacionit të krimit të urrejtjes për mbrojtjen e individëve trans në vitin 2009, ajo nuk vlejti asgjë në asnjë nga këto raste të lartpërmendura.

Gjatë gjykimit të saj, asaj vazhdimisht iu referua si një 'njeri' por kur u dërgua në burg ajo ishte vënë në një burg të meshkujve, ku edhe pasoi abuzime të mëtejshme. Policia në rastin e IslanNettels duket se u mungon motivimi për të hetuar dhe madje pretendoi se kamerat jashtë stacionit të policisë nuk kishin punuar atë natë të sulmit të saj. CeCe do të përballet me pengesa të shumta në gjetjen e punësimit dhe strehimit me një dosje penale dhe madje edhe më shumë si një grua trans ndërsa familja Nettels ka humbur vajzën e bukur të tyre

Përvojar e CeCeMcDonald dhe Islan Nettels nuk janë të izoluara, por janëpërvoja të përditshme qëshumë individë trans përjetojnëçdo ditë. Gratë trans janë në shënjestër vazhdimisht nga policia për punën e seksit dhe përdorim të drogës, duke ju mohuar të drejtat themelore të njeriut për strehim dhe punësim, duke u diskriminuar edhe më shumë se lesbiket, gejët, biseksualët. Ligji jo vetëm që dështon për të mbrojtur njerëzit LGBT kundër dhunës në Kosovë, por edhe nëShtetet e Bashkuara e cila shpeshështë vënë në një pjatë të artë për të drejtat e njeriut, kur në realitet ajo është një pjatë me baltë. Të dy rastet e CeCe dhe Islan-së kanë fituar një vëmendje duke u pasuar me protesta në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe në botë, por drejtësia ende nuk është vënëdhe zërat e qindra në mos mijëra individëve trans vazhdojnë të mos dëgjohen çdo ditë. Shokë Trans duhet drejtësia të vihet TANI jo vetëm nga shteti, por edhe nga shoqëria, pjesë e së cilës jeni edhe ju. Revolucioni fillon në shtëpi.



nga: Brogan Geurts

# Krenaritë dhe Paragjykimet

**Dorëzuar në Charlotte Observer, gusht 2013**

*Krenari: Vet-respekt i arsyeshëm ose i justifikuesbëm; vetëdija e dinjitetit të një personi*

E braktisa Karolinën e Veriut kur isha nëntëmbëdhjetë vjeçar, për të shkuar në kolegj në Ohajo. Isha i njohur për zvarritje të fjalëve, për mbajtjen e çajit tëëmbël në frigoriferin e vogël të dhomës së konviktit, dhe për pranimin përmes postës e Cheerëëine nga babai im. Gjatë vitit të dytë të studimeve në mesin e fushave të misrit tëMidëëestern (perëndimit të mesëm), isha me fatpër tu përzgjedhur për ndjekjen e një programi prestigjioz të praktikës së punës, që do më dërgonte në Çikago atë verë. Punova për Fondin Lambda të Mbrojtjes Ligjore dhe Edukimit – një firmë ligjore jofitimprurëse që prekte diskriminimin në baza të orientimit seksual ose identiteti gjinor.

Ishte vera e vitit 2003, dhe pjesë e punës sime nëLambda ishte organizimi i karvanit tonë për Paradën e përvitshme të Krenarisë në Çikago. MeqëLamdaështë organizatë ligjore e avokaturës, unë rregullova njëkarvan në formë të sallës së gjyqit. Nëntë "Gjyqtarët" me rrobë të zeze po i bënin ballë vapës së verës, tëpajisurme çekanë duke përfaqësuar kështu çekanët e Gjykatës Supreme. Për tëqenë të sinqertëkarvani jonë nuk ishte më interesanti në paradë. Por diçka ndodhi tre ditë para Paradës së Çikagos. Më 26 qershor 2003, Gjykata Supreme e vërtetë vendosi mbi çështjen Laëërence kundër Teksasit, duke de-kriminalizuar aktivitetin seksual me konsensus tëtë rriturve në një hapësirë private. Përderisa karvani i krenarisë sonë po kalonte poshtë rrugës sëWindyCity (Qytetit të Erës), turma u ndal. Reagimet ishin dërrmuese: duartrokitjenderuese, admirim i heshtur, lot të vlerësimit. Festa e krenarisë u ndal për një moment, dhe secili kujtoi që vetëm tre ditë më herët, ne kemi qenë në rrezik të një sanksioni kriminal në trembëdhjetë shtete.

Që nga karvani i zyrës ligjore Lambda, një 21-vjeçar nga Karolina e Veriut pa mijëra njerëz të cilët, për të parën herë, mund të thoshin kudo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës: "Unë nuk jam i jashtëligjshëm".

Menjëherë mendova si ky vendim i Gjykatës Supreme ka ndikuar në jetën time. Zbulova se, pa e ditur, kisha shkelur një ligj në vendlindjen time. Në tënjëjtën kohë u ndjeva në turp për sanksionin kriminal përderisa festoja heqjen e këtij sanksioni nga gjykata më e lartë në vend. Ç 'është më e rëndësishme, kuptova se unë do të isha një aktivist për tërë jetën. Dhjetë vite pas asaj Krenarie tëinstrumentalizuar, jam duke punuar për një organizatë ndërkombëtare të vendosur në Bruksel. Në IGLYO (Organizata Studentore Ndërkombëtare e Lesbikeve, Gejëve, Biseksualëve, Transvestitëve dhe tërinjëveQueer), unë përfaqësoj nevojat dhe interesat e tërinjve LGBTQ në nivelin Evropian. Këtë verë, u ftova për të marrë pjesë në Krenarinë Baltike, nëVilnus, Lituani.

Marshova në të dytën Krenari tëVilnusit. Numri i policëve mbrojtës tejkalonte atë të marshuesve të krenarisë përderisa numri i anti-protestuesve tejkalonte atë të policëve. Marshova përskajskinheadsaveme shenja homofobike që bënin thirrje për vdekjen time, kalova gra të moshuara që bërtisnin nga thellësia e mushkërive të tyre për shkatërrimin e shoqërisë, dhe përskaj fëmijëve të heshtur që mbanin dy gishtet e mëdhenj të dorës të ulur poshtë, me ngrysje të vetullave të shëmtuara në fytyrat e tyre. Gjithashtu, marshova pranë familjeve që duartrokisnin në mbështetje, marshova me qindra gej e lesbike të Lituanisë që festonin identitetin e tyre, dhe marshova pranë një të riu Lituanes që nuk mund të bindte asnjë nga miqtë e tij për të ardhur në paradë – por marshonte gjithsesi.

Për momentin, jam kthyer nëKarolinën e Veriut për të vizituar familjen dhe miqtë dhe për të thithur ato rreze






dielli që ne të gjithë do të donim të kishim mundësinë për ta paketuar e shitur. Unë nuk ec përskaj njerëzve që mëpështyjnë e hedhin vezë. Nuk kame ecur asnjëherë. Forma jugore e homofobisëështë më e mprehtë. Vitin e kaluar, një nga amendamentet mbi martesën kushtetuese më me ndikim dhe diskriminues në Shtetet e Bashkuara u miratua nëKarolinën e Veriut. Ky amendament ishte një masë e panevojshme ligjore; ne tashmë kishim një ligj shtetëror që ndalonte martesën e seksit tënjëjtë. Për mua, rezultati i referendumit ishte zhgënjyes, po jo befasues. Njësoj ishte e dhimbshme për mua si shteti im po merrte të tillë hapa, vendosmërisht prapa.

Sigurisht, Karolina e Veriut nuk është I vetmi vend me legjislacion të tille. Në Rusi ka ligje të tilla të miratuara që ndalojnë të ashtuquajturën "Propaganda Gej". Këto ligje të paqarta dhe pasakta e bëjnë ilegale vet ekzistimin e një personi gej, dhe entuziazmi për të tilla ligje po përhapet shpejtë në shtetet si Ukraina, Moldavia e Lituania. Vëmendja ndërkombëtare është përqendruar mbi situatën ruse përderisa ligjet kanë shkaktuar eskalim të dhunës kundrejt lesbikeve, gejëve, dhe njerëzve transgjinor.

Nuk është vështirë të shihet si stigma ligjore justifikon sjelljen fanatike. Dhe nuk është gjithashtu vështirë për të parë si ligjet homofobike në Rusi vijnë nga i njëjti vend si amendamentii panevojshëm dhe ekstrem i martesës nëKarolinën e Veriut. Të mohuarit e qasjes në njëinstitucion civil për një klasë të qytetarëve nuk është asgjë më pak se diskriminim, e as më shumë apo më pak se të mohuarit e të drejtës së lirisë së shprehjes apo të drejtës sëtubimit. Karolinasit Verior nuk janë drejtuar nga dhuna; kjo nuk do të thotë që miratimi i këtij amendamenti vjen nga një vend më pak i dhimbshëm.

Javën tjetër, Charlotte zPride do të pres njërën nga festivalet të mbajtur që nga vitet 1970. Krenaria e Charlotte 2013 shënon një ditë historike: tëdielën, më 25 gusht, do të mbahet parada e parë e Krenarisë që nga viti 1994. Shpresoj që ngjarja do jetë një sukses I bujshëm, po aq sa Krenaritë në të cilat kam marrë pjesë këtë vit.

Kanë kaluar dhjetë vite që nga koha kur Gjykata Supreme ka deklaruar se njerëzit gej dhe lesbike nuk mund të sanksionohen për aktivitete private me konsensus. Për këto dhjetë vite, trembëdhjetë shtete dhe distrikti i Kolumbisë kanë njohur të drejtën e gejëve dhe lesbikeve për mos u trajtuar si qytetarë të klasës të dytë duke njohur të drejtën martesore. Dhe Karolina e Veriut ka bërë çdo gjë që ka mundur për të rrënjosur diskriminimin sa më thellë që të jetë e mundur në ligj.

Edhe pse jam shpërngulur qe dhjetë vite tashmë dhe pesë nga këto vite i kam jetuar në Evropë, jam krenar ta quaj veten Karolinas Verior kudo që jam. Jam gjithashtu krenar që jam gej. Shpresoj që një ditë, këto krenari nuk do të ekzistojnë në tensionin që e kanë tash. Shpresoj që shpejtë, do të mund të jem krenar për Karolinën e Veriut për atë se ky shtet trajton të gjithë njerëzit me dinjitet, pavarësisht orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor. Gëzuar Krenarinë, Charlotte.

**Jordan Long ka lindur në Atlanta, Gjorgja, dhe është rritur ne Methju, Karolina e Veriut. Ai ka diplomuar nga ProvidenceDaySchool e Charlotte në vitin 2001. Ka diplomuar si student nderi dhe I dalluar nga Universititeti I Majamit në Ohajo, ka marrë nivelin master prej Universitetit të Çikagos dhe titullin JD nga Universiteti I Shkollës Juridike të Miçigenit. Në vitin 2010, ai ka pranuar një grant kërkimi Fulbright nga Departamenti I Shtetit të Shteteve të Bashkuara. Për momentin jeton në Bruksel, Blegjikë me partnerin e tij danez – ata tashmë mund të martohen dhe vijnë në Shtetet e Bashkuara.**

# PAMJET DHE STEREOTIPET




Ky person alitet identifikohet më shumë me djem Gej si në stil dhe ndjeshmëri, edhe pse ata ende shpesh i frekuentojnë qendrat e DYKE ,ata me kujdes zgjedhin cilësinë e mirë, pantallona sportive dhe farmerka që përputhen me çizme. Flokët e tyre janë zakonisht një prerje e shkurtër te shprishura. Ata nga një herë janë të njohur edhe si Butch të butë.




Këto vajza me stil janë aktivë në skenën e lezbikeve, por ato janë tërheqëse edhe në drejtim shpirtëror. Ato kanë tejmbushur dollapet me veshje dhe këpucë të cilësisë së mirë. Ato do të ju pyesin në fillim për shenjën tuaj pastaj për emrin ato arrijnë të realizojnë një palë vathë kristal pa u shfaqur shumë hipi. Ato janë të San Francisco që është, deri sa të shkojë në New Mexico për të zë vend.




Pamja: Ju mund të gjeni këto persona Butch në krahun e një Femme të ashpër. Ato duan këmisha të rrepta, dhe kapele. Këpucët e tyre janë të lëmuar, dhe madje edhe kur ata veshin xhinse, pantallona e tyre janë të shtypur. Vetëm flokët e tyre marrin orë për ti krehur dhe vendosin xhel të duken të përkryer. Pak i njohur fakti jashtë komunitetit Dyke: Butches shpenzojnë më shumë kohë në mënyrën e flokët e tyre se sa Femmes.




Duke ju falënderuar lesbikeve shkrimtare si Michelle Tea, skena e lesbikeve të literaturës sa po forcohet. Këto zonja shpesh kanë flokë të shthurura, dhe syze të doktorit. Ato blejnë në shitore të dorës së dyte sepse kush mund të përballoj çmimet e teshave me një pagë të shkrimtarit? Këto mund të jenë Butch, android apo edhe feminin, por identiteti i tyre kryesor është se ato janë poete.




Këto gra janë pjesë e lëvizjes fermerëve urbane. Ato shpesh janë të veshura me këmisha të kauboj, çizme, dhe xhinse të cilësisë së mirë. Ato jetojnë në Misionin e jashtme dhe Bernal Heights, dhe do të mbushin oborret e tyre të vogël me pula, koshere, dhe ndoshta edhe dhi. Ato frekuentojnë (ose ndoshta të punojnë ) Rainbow. Shpesh si mësues apo punonjës socialë, ato e mbushin kohën e lirë duke ja mësuar kopshtarinë të rinjve të qytetit.




Këto gra duan biciklen e tyre dhe skateboardin, si dhe duksa dhe xhinse të shtrenjta, gjithmonë me një anën zinxhirin. Ato mund të veshin atlete dhe një kapelë, por ato do të jenë në edicionin e kufizuar Furgona dhe një kapak i dërguar i punuar me dorë. Këto vajza janë të vështira dhe sportiv, por ju nuk do ti kapni ato në fakt duke shikuar sport - përveç Roller Derby ose mundje në armaturë.



# Jeta e dyfishtë



Tanimë kjo shprehje po gjen strehim te një numër i madh i personave të komunitetit LGBT, duke më përfshirë edhe mua. Imagjino njerëzimi mezi i del ballë ta jetojë jetën për të cilën e njohin të gjithë, e lërë më të ketë edhe një tjetër jetë me persona të caktuar. Për katër vite me radhë isha edhe unë viktimë e kësaj tragjedie shpirtërore duke u fshehur pas asaj çka në të vërtetë isha dhe duke u maskuar në një person me dy role dhe karaktere të ndryshme. Jeta si një lesbike apo gej në Kosovë është më së e vështirë pothuajse për të gjithë, dhe nëpër një situatë të tillë kalova dhe unë, duke luajtur një rol shoqeje me të dashurën time gjatë gjithë ditës në sy të të tjerëve dhe familjes dhe në mbrëmje kur flinim gjumë atëherë e kuptoja qe isha e dashura e saj, vetëm brenda katër mureve në errësire aty dilte shpirti im i vërtetë dhe luaja rolin e vërtetë të karakterit dhe vetës time. Aty kisha të vetmen mundësi të shpërthejа vullkanin e zjarrtë qe mblidhej gjatë gjithë ditës brenda meje. Një jetë me dy emra, dy identitete, dy numra të ndryshëm celulari dhe dy e-mail adresa të ndryshme duke bërë të pamundurën e humbjes së gjurmëve që qonin drejt një dashurie të të njëjtës gjini vetëm e vetëm për të qëndruar bashkë. Kjo ishte e tmerrshme për nga ana e jashtme dhe presioni qe krijohej thuajse çdo ditë mirëpo momentet kur isha vetja dhe çastet që shpirti im frymonte lirshëm dhe nxirrte jashtë atë pjesë që ishte e rezervuar nga sytë e botës më bënte të harrojë gjithçka që më motivonte për të vazhduar qoftë edhe një jetë në atë errësire. E dija, nuk isha e vetmja unë e dija që kishte një numër shumë të madh të njerëzve që përballeshin më të njëjtën situatë, gjithmonë pyesja veten se deri kur do zgjaste kjo situatë depresioni, ky tmerr i dhunimit të të drejtës së shprehurit të dashurisë. Më vinte të bërtisja shpeshherë të nxirrja jashtë krejt atë mllef që kisha brenda vetës mirëpo e dija që gjërat do ngatërroheshin dhe çdo gjë do të bëhej më e tmerrshme se që ishte... Tani që gjërat kanë marrë një ndryshim dhe kahje tjetër, nuk është njëjtë sikur në kohën kur unëi përjetova të gjitha këto është pakëz më ndryshe mirëpo prapë jemi të izoluar brenda dëshirës dhe vullnetit tonë. Shpresoj në një ndryshim të madhe shpresoj në një vetëdijesim gjithëpërfshirës...shpresoj dhe lutem në emër të të gjithëve që njëherë e përgjithmonë të fluturojë lirshëm dëshira jonë e madhe për të qenë vetja kudo që jemi, se nuk është jetë e duhur jeta e bërë nën hije.

nga: L.K



# Çfarë do të thotë të jesh Transgjinor/Transseksual?

Fjala transgjinor nënkupton personin që ka identitet gjinor të ndryshëm nga seksi të cilit ai/ajo i përket. Komuniteti transgjinorbënë pjesë në komunitetinLGBT por ka shume dallim nga orientimet seksuale LGB. Fjala transgjinor përcakton gjininë e një personit që bazohet në atë çfarë ka ne mendje dhe si ndihet e jo në organin gjenital. Pra transgjinorjanë persona tëcilët bazohen në atë se si ndihen dhe shohin vetën nëanën intelektuale dhe emocionale dhe jo atë fizike.

Në shumë mënyra shpjegohet si "I lindur në trup të gabuar".

Të jesh transseksual dallon nga fjala transgjinor. Transseksual janë persona të cilët e kanë filluar apo mbaruar procesin e ndryshimit të seksit të tyre duke përfshi trajtimin hormonal dhe apondërrimin e organit gjenital.

Të jesh transseksual nuk do thotë se do jesh gjithsesi heteroseksual pas procesit. Në disa raste transseksualet nga femër në mashkull apo nga mashkull në femër vazhdojnëtë kenë ndjenja për gjininë e njëjtë. Pra mund të jesh transseksual gej apo lesbike.



**CD REVIEW**

### PLANNING TO ROCK "ALL LOVE IS LEGAL"

Lëshuar në shkurt të vitit 2014, albumi "Çdo Dashuri është Legale" e grupit Planningtorock është ndër albumet më tëzëshëmmbiseksualitetin, gjininë, dhe barazinë nëvitet e fundit. Kënga e parë fillon me një ritëm të lehtë elektronik dhe me fjalët "Bjer në dashuri me kë të duash ti" që përsëriten nga një zë që nuk mund të klasifikohet as si i një burri, gruaje, i dikujt në mes apo asnjërit nga këta. Me tituj këngësh qëvariojnë nga "Le të flasim për gjininë e Dashur", "Patriarkia Fund dhe Jashtë", "Misogjonia ra e vdekur", disa tekste këngësh mund të duken si slogane promocionale, përderisa të tjerat janë mjaft të thella dhe radikale. Ky albumi më bëri të ndjehem sikur po lexoja një libër që provokon mendim të thellë por gjithashtu më dha dëshirën për të vallëzuar. Tingulli i albumit nuk është i lehtë për tu kategorizuar por kreativiteti dhe natyra artistike mund të ndjehen duke u pumpuar përmes altoparlantëve; të kujtojnë artistët si The Knife, LightAsylum, andiamamiwhoami.



# Diskriminimi i Transgjinorëve / Transseksualeve



Në vitin 1979, Homoseksualiteti klasifikohej si një sëmundje në Suedi. Suedezët protestuan duke thirrur në punë për të u lajmëruar si të sëmurë , dhe duke thënë po ndihem GAY.

Termi Transgjinor/Transseksualështë mjaftë rralle i përmendur apo i dëgjuar në Kosovë.

Por fakti që këta individë janë pjesë e komunitetit LGBT nënkupton që janë shumë të diskriminuar, për më tepër shpesh diskriminohen edhe brenda komunitetit LGB. Fjala Transgjinor/Transeksualështështëshpesh i keqkuptuar nga njerëzit.

Reagimi dhe komentet e njerëzvetë informuar me këtë komunitet që janë homofob apo transfob (frika e paarsyeshme nga transgjinorët) janë kundër këtyre "krijesave". Komentet shpesh herë mund ti hasim edhe mëpërmbajte banale. Në shumicën e rasteve duke thënë "Zoti e ka krijuar personin/njeriun me gjininë që ka, dhe ai duhet ta respektoj atë", "Një person s'mund të jetë unik apo vetvetja përderisa do qëtë kaloj në një gjini tjetër","ktheju gjinisëtënde se s'tëmerr kërkush","zoti nuk i donënjerëzit si ti", "të ishe kanëqika/djali jem t'kishavra","t'ishakanën'vend tënd kisha ba vetëvrasje"

Apo pyetje provokative me përmbajtje ngacmimi si "A je djalë a qik?" ,"pse s'pe ndërron stilin?"...

Në Kosove edhe mund të hasim dhunë fizike veçanërishtte individëttë cilët nuk janë aq të informuar në lidhje me ligjet sa i përket komunitetit LGBT dhe ndihen të pa mbrojtur.

Kjo më së shumti ndodh si pasoj e mungesës së informimit të njerëzve dhe po ashtu mungesës së marrjes se informimit nga mediat nacionale.

Njerëzit homofob/transfobtë cilët termin transgjinor e shohin si "sëmundje" apo diçka jo njerëzorejanëtë pa informuar se të jesh transgjinor/transseksual nuk ështëka të bëjë vetëm me nevojë seksuale por edhe me nevojat personale emocionale, psikologjike dhe morale.

Diskriminimi i Transgjinoreve/Transseksualeve nuk ndodh vetëm nga shoqëria në rrugë por edhe në institucione dhe nga njerëzit që janëtë punësuar në punështetërorë si mësimdhënësit, kolegët, drejtoret etj.

I ashtuquajtur diskriminim vjen si pasoj edhe nga mungesa e ligjeve aktuale në krahasim me ato të shteteve perëndimore, për shembull nëdokumentet personale nëse je transgjinor apo transseksual e vetmja gjini që mund të shkruhet në dokument është gjinia biologjike që ti ke.

Ngacmimet dhe diskriminimi ndaj transgjioreve/transseksualeve janëtë rënda si përshembull detyrimi për ndryshimin e pamjes fizike të personit,detyrimi i martesës,frika për të shprehur mendimin,ndjenjat që një individ transgjinor ka. Poashtutransgjinorët zakonisht përfundojnë edhe duke detyruar vetën të fshehin identitetin e tyre gjinor dhe të paraqitën në publik vetëm si gej apo lesbike pasi që në Kosovë është e pamundur ndryshimi i seksit. Po ashtu përfundojnë edhe duke krijuar urrejtje ndaj këtij komuniteti dhe mbi të gjitha ndaj vetës.

Gej, lesbike, biseksual, transgjinor – njerëzit janë njerëz

**nga: Judith Light**



# Dhuna ndaj komunitetit LGBT në Kosovë

Siç dihet në vendin tonë mungon liria e shprehjes apo veprimit dhe ka gjëra, çështje e tema të cilat janë tabu dhe të pa pranueshme për shumicën. Ndër këto çështje hynë edhe komuniteti LGBT i cili është një nga komunitetet më të paragjykuara, e shpesh edhe në radhën e komuniteteve më të sulmuar fizikisht, e mos të flasim për format tjera të dhunës. Numri i saktë i personave LGB T të sulmuar në Kosovë nuk dihet për shkak se shumicën e herëve, personat e sulmuar nuk i raportojnë këto raste duke pasur frikën nga zbulimi i identitetit të tyre seksual, mos besimi se do të trajtohen në formën e duhur nga institucionet, etj.

Nga rastet më të përfolura të dhunës ndaj komunitetit LGBT janë edhe rastet që ndodhën me 14 Dhjetor te vitit 2012 ku ndodhë n dy sulme të ndryshme njëra pas tjetrës , ndaj organizimit të revistës Kosovo 2.0 si dhe sulmit tjetër ndaj një vajze në një tubimi që po mbahej në njërën nga organizatat LGBT funksionale në atë kohë 16 Dhjetor 2012

Institucionet, edhe pse*përkrahëse*, në fjalë, realisht nuk kanë dhënë ndonjë rezultat konkret deri më tani në gjetjen e autorëve të cilët fshihen pas sulmeve të dhjetorit 2012 ndaj komunitetit LGBT. Kjo fatkeqësisht, e zbeh besimin apo vullnetin e marrjes së vendimit nga personat LGBT të sulmuar për tu drejtuar në polici apo institucione.

Raste jo të rralla të dhunës, sulmeve apo tentim sulmeve dëgjohet të ndodhin edhe në zonat publike të njohura nga komuniteti LGBT si hapësirë për të u takuar ka pas shpesh raste kur individ të ndryshëm të komunitetit kanë rrëfyer për sulmet që u janë bërë në këto zona, por, shumica prej këtyre rasteve përfundojnë në heshtje nga se nuk raportohen në polici. Ajo që është e nevojshme për tu bërë që kjo gjendje të ndryshoj një ditë, është puna e mëtutjeshme në vetëdijesimin e personave LGBT për të drejtat dhe liritë që u takojnë me ligj, si dhe po ashtu puna me institucionet si policinë, në lidhje me rritjen e besimit në këtë komunitet për të raportuar rastet e dhunës.

Si qytetare e Kosovës edhe si një aktiviste e komunitetit LGBT edhe ne jemi njerëz si të gjithë qytetaret e Kosovës, që ti kemi të drejtat e barabarta, sikur të kishim pas një qeveri më të mirë që të punohej në çështjen e komunitetit LGBT, në shumë vende tjera të botës i kanë të drejtat e barabarta, por fatkeqësisht në një Kosovë demokratike kjo e drejt nuk ekziston aspak te ne, se jemi të diskriminuar deri ne pikën e fundit ku vetëdija e njerëzve është nën zero, kishte me qenë shumë mirë nëse qeveria e Kosovës, me na përkrah ma shumë me fol më shumë për çështjen e komunitetit LGBT edhe nëpër media apo gazeta apo sidoqoftë me qu pluhur ma shumë.

Ka disa raste në Kosovë qe janë raportuar po sipas të gjitha gjasave ato raste nuk janë marr parasysh, pse duhet të ndodh një gjë e tillë në një Kosovë demokratike shtrohet pyetja, pse kur vjen puna te komuniteti LGBT në do raste Policia e Kosovës u tregu jo profesionale si për shembull një anëtar i komunitet e ka raportuar rastin edhe është marr në pyetje e çka boni ju ose më mirë të them që sjelljet e policëve në stacionin e policisë kishin qen jo të hijshme. Një rast tjetër që është raportuar policia kishte qenë shumë ma profesionale se në rastet tjera, pasi që kanë formuar një njësi special vetëm për komunitetin LGBT, por edhe kjo njësi duhet të ketë më shumë trajnime.

Nuk jam aspak e kënaqur me institucionet tona gjykata, prokuroria, policia, duke e përfshi edhe Eulexin se nuk janë në gjendje me i qu rastet deri në fund më mirë të them që i anashkalojnë. Sikurse te kishim pas një shtet më të fort mendoj që shumë do të ishte më mirë. Më dhemb shumë që nuk e kemi lirin e shprehjes si një komunitet sikur të lëviznim me një liri të barabarta po këtu gjithë duhet me i shti hundë te feja sikur shumë hoxhallarë që shprehen në një mënyrë tepër fyese kur flasin për komunitetin LGBT "këta njerëz janë të sëmur", nuk i jepet e drejta askujt mu shpreh në atë mënyra secili i ka të drejtat e veta pa marr parasysh fenë, gjininë apo racën. Pse i lejohet një hoxhës apo ndonjë anëtarit të fesë islame me fol çka është një e zezë për komunitetin LGBT ku është qeveria jonë, që nuk e merr asnjë masë ndaj tyre. Kjo situatë duhet të ndryshoj vetëdija e njerëzve duhet të rritet ma shumë po ashtu edhe në qeveri, polici si dhe në gjykata. Institucionet tona duhet të bëjnë më shumë që të implementohet ligji i diskriminimit ndaj personave që diskriminojnë të drejtat e komunitetit LGBT.

# Gej dhe Edukimi




Homoseksualiteti është sëmundje. Kjo është ajo çka mësojnë në shkolla fëmijët tanë. Ndërsa Shoqata Amerikane e Psikiatrisë e ka de-klasifikuar si çrregullim mendor që nga viti 1973, duke u pasuar nga shumë organizata të shëndetit mendor, kur në fund u largua edhe nga Organizata Shëndetësore Botërore në vitin 1990. Por në shkollat tona ende mësohet që homoseksualitetiështë sëmundje, dhe fëmijët tanë ende e mësojnë një gjë të gabuar. Ndoshta deri më tani askush nuk u ka bërë presion të mjaftueshëm organeve përgjegjëse për këtë problem ose edhe organet përgjegjëse nuk janë të gatshme të lënë homofobinë e tyre në shtëpi kur e fillojnë punën e tyre. Ndërsa Ligji kundër diskriminimit në Kosovë mbron edhe të drejtat e komunitetit LGBT, gabime të tilla ende mund të hasim. Ndoshta është edhe mungesa e informacionit nga ana e mësimdhënësve për komunitetin LGBT,apo është problemi që mësohet shumë pak për personat LGBT në shkolla dhe atë që mësohet është e gabuar. Nuk janë vetëm mësimet në shkollë që e thonë këtë, janë edhe mësimet fetare dhe predikuesit fetar që me thirrjet e tyre për urrejtje e dhunë çdo ditë e më shumë po u ngulisin në kokë popullatësgjëra të gabuara për komunitetin LGBT, edhe për gjuhë të urrejtjes ekziston ligji në Kosovë, por siç duket edhe këtu organet e drejtësisë kanë dështuar në kryerjen e detyrëstëtyre.

Si pasojë e këtyre predikimeve të gabuara ndodhin shumë vetëvrasje në gjithë botën. Sipas disa studimeve të bëra në Amerikë 2/3 e vetëvrasjeve që kryhen nga adoleshentët vinë si pasojë e ngacmimeve nëpër shkolla për shkak të orientimit të tyre seksual. Ngacmimet bëhen edhe nga vetë arsimtarët dhe profesorët, por edhe nga nxënësit e tjerë, është një fakt që e dimë të gjithë dhe e kemi përjetuar shumica e komunitetit LGBT. Një gjë e tille gjithashtu dënohet për shkak që në ligjin për diskriminimbashkëngjitet edhe ngacmimi. Gjithsesi në Kosovë ka organizata që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT, njëra prej tyre është edhe QESh(Qendra për Emancipim Shoqëror) që punon përavokim dhe lobim për të drejtat e komunitetit LGBT, dhe kjo organizatë është duke u përpjekur që të avokojduke shfrytëzuar ligjetekzistuese për të ndryshuar mënyrën se si i qasen komunitetit LGBT në shkolla të mesme dhe universiteteve,ku mësohetqë homoseksualiteti është sëmundje. QESh në planin e aktiviteteve të saj në bashkëpunim me qeverinë e ka edhe trajnimin e arsimtarëve dhe profesorëve se si të sillen me nxënësit dhe studentët e tyre LGBT, për uljen e diskriminimit në shkolla dhe universitete. Ndoshta edukimi nuk është problemi kryesorë sa i përket komunitetit LGBT, por fëmijët bazën e njohurive të tyre e marrin nëpër shkolla, dhe për këtë duhet të luftojmësë bashku kundër ngacmimeve dhe diskriminimit që bëhetndaj komunitetit LGBT duke mbrojtur njëri tjetrin. Dhe gjithashtu të mos nëpërkëmbemi por të qohemi e të luftojmë për të drejtat tona, e njëra prej tyre është e drejta për Edukim.



**Lajmet Për LGBT-në në gjith botën**



## Ministrja gjermane e Mjedisit Barbara Hendricks ka dalë

Ajo është Ministrja e parë gjermane e cila doli haptazi dhe pranoi qëështë lesbike.

Në një intervistë, e cila ishte me të vërtetë në lidhje me diçka tjetër përveç orientimit të saj seksual, Hendricks flet për partneren e saj të jetës. 62-vjeçaren, e cili është katolike, ka qenë anëtaree Partisë Social Demokrate Gjermane, SPD, për 20 vjet. Urime Gjermani!



## Michael Sam del haptazi

Michael Sam, i cili luajti për Universitetin e Missouri, del si homoseksualë në New York Times. Michael është 24 vjeç dhe duke u bërë lojtari i parë i futbollit në NFL që është haptazi homoseksual. Urime U.S!






## Zhytësi Brazilian Ian Matos tregon për seksualitetin e tij

Pas zhytësit britanik, TomDaley doli në një clip nëYouTube, atletikë të shumtë më tepër kanë marre guximin për te dalë haptazi, në mesin e tyre është edhe zhytësi braziliane, IanMatos.

Më parë, ai kishte frikë se mos humb sponsorët, por tani ai mendon se është e mirë për të shkuar në klubet e gejëve, pa pasur nevojë të mendoj se nëse ai do të jetë i ekspozuar dhe për të shmangur që ka për të fshehur te dashurinë. Urime Brazil!



## Monumenti memorial në Izrael

Një memorial për viktimat homoseksualë të terrorit nazist është hapur në Tel Aviv.

Ajo është monumenti i parë në kujtim të Izraelit viktimave të nazizmit, ku viktimat çifute dhe jo-hebrenj janë të njohur.

Monumentet në përkujtim të viktimave Homoseksualë janë hapur edhe më parë në Berlin, Amsterdam, Sydney dhe San Francisko. Urime Izrael!

ILGA EUROPE

Equality for lesbian, gay, bisexual, trans and intersex people in Europe

## Verdikti i BE forcon ligjin e punës

Në një aktgjykim nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, konstaton se çiftet e të njëjtit seks në partneritet duhet të kenëtë njëjtat përfitime në vendin e punës, si të atyre çifteve mes gjinive të kundërte të martuara. ILGA Europe mirëpret vendimin në një njoftim për shtyp. Aktgjykimi thekson se qytetarët e BE të cilët formuan një partneritet do të trajtohen si çiftet e martuara kur është fjala për përfitime në vendin e punës. Urime BE-së!

SPECIAL GAY OF THE DAY

# Një Angazhim shumë i gjatë – Edith Spyer – luftëtar për dashuri dhe barazi



"Kur Thea dhe unë u takuam gati 50 vjet më parë, ne nuk mund të kishim ëndërruar se historia e jetës sonë së bashku do të ishte në Gjykatën e Lartë si një shembull se përse çiftet gej dhe lesbike të martuara duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe jo si qytetarë të klasës së dytë. ndërsa Thea nuk është më gjallë, unë e di se sa krenare ajo do të kishte qenë për të parë ditën e sotme. E vërteta është, unë kurrë nuk kamë pritur ndonjë gjë më pak nga vendi im. «- Domandërgjyqëse- EdithWindsor, 83 vjeç

Imagjinoni kur ta gjeni dashurinë e jetës suaj. Ai person ju bën të plotë, dhe energjia e tyre në jetën tuaj ju bën një person më të mirë, më të suksesshëm. Megjithatë, shoqëria njeh dashurinë tuaj si një sëmundje dhe një vepër penale .Por, dashuria juaj për njëri-tjetrin është aq e madhe se asgjë nuk mund të ju ndalojë nga të qenit së bashku. EdithWindsor dhe TheaSpyer u takuan në një parti në vitin 1962, kur njerëzit homoseksual dhe lesbike janë konsideruar kryesisht si kriminel dhe madje edhe të diagnostikuar si të sëmurë mendorë. Në një pikë në jetën e saj, Thea u përjashtua nga SarahLawrenceCollege kur ajo u kap nga një roje e sigurisë duke puthur me një grua të vjetër. Megjithatë, pavarësisht nga shtypja dhe homofobisë të asaj kohe në Shtetet e Bashkuara, dy të dashuruar bukur vazhduan jetën e tyre, duke udhëtuar nëpër botë dhe kultivimin e dashurinë e tyre për njëri-tjetrin.

Pas takim për një kohë të shkurtër, Spyer u propozua për Windsor në vitin 1967. Pas një angazhimi shumë të gjatë prej 40 vitesh, çifti u martua më në fund në Kanada në vitin 2007. Gjendja Shëndetësore e Spyer ngadalë u përkeqësuar gjatë viteve, dhe ajo u diagnostikua me sklerozë të shumëfishtë në moshën 45 vjeç, një sëmundje që nuk ka ndaluar disa nga vallëzimi-edhe kur Spyer u godit në një karrige me rrota.Në vitin 2009, partner Windsor-së prej më shumë se dyzet vjet, TheaSpyer, vdiq, duke lënë Windsor si trashëgimtar i saj i vetëm. Të dyja ishin të martuar ligjërisht në Kanada, në vitin 2007, por, për shkak të Mbrojtjes së aktit Martesor , Windsor nuk kishte të drejtën për përjashtimin për tatimin e pasurive që vlen për burrat dhe gratë. Ajo kishte për të paguar 363.053 $ në taksa të qeverisë federale, dhe 275.528 $ në shtetin e Nju Jorkut, dhe ajo nuk mendonte që ishte e drejtë.Windsor 83 vjeçar vendosi se ajo ishte mjaft e diskriminuar dhe vendosi për të luftuar në Shtetet e Bashkuara me ligj.

Edhe pse partneri i saj i martuar shkoi, EdithWindsor ishte lodhur nga diskriminimi i saj dhe shumë çifte të tjera LGBT po përballe, më shumë se 40 vjet për të qenë së bashku dhe në të thellë dashuria nuk ishte e mjaftueshme për qeverinë e SHBA për ti njohur ato si një çift ose të barabartë me çiftet e tjera të martuara.

Më 26 qershor 2013 EdithWindsor fitoi rastin e saj, në të cilën Gjykata Supreme ka vendosur se martesa e Mbrojtjes si antikushtetues. Jo vetëm që znjWindsormori paratë e saj prapa, por ajo e ka ndryshuar historinë për çifte LGBT në Shtetet e Bashkuara përgjithmonë. Tani, çiftet e martuara LGBT do të njihet të barabartë me çiftet heteroseksuale në mos pasur nevojë të paguajnë taksa për pasuritë që ata marrin nga partnerët e tyre.Para se ta fitoj rastin e saj kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Windsor u tha nga shumë organizata LGBT dhe avokatëve se kjo nuk ishte koha për të luftuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës ligjit kundër martesës. Por ajo nuk u dorëzua. Ajo ka deklaruar se nuk ishte vetëm rreth saj dhe Thea, kjo ishte për të gjitha çiftet që janë të diskriminuara.

EdithWindsor është një grua që ka përjetuar dhe dëshmuar rrethanat të ndryshme për njerëz LGBT në Shtetet e Bashkuara dhe në Botë. Për një kohë të gjatë, ajo kishte për ta mbajtur marrëdhënie e saj të fshehtë. Ajo dhe partneri i saj u përballën me forma të ndryshme të diskriminimit. Megjithatë, ajo nuk u dorëzua; në vend të kësaj ajo ka luftuar deri në fund për të ndryshuar jetën e saj dhe jetën e shumë çifteve LGBT në të tashmen dhe të ardhmen.

**nga: Blerta Avdili**



BOOK REVIEW

## "INDESTRUCTIBLE"




Cristy C. Road në librin e saj Indestructible,flet për vitet që kaloi në shkollën fillore dhe të mesme në Miami – ku u ballafaqua trimërisht për të gjetur dhe mbrojtur identitetin e saj gjinor, rrënjët kulturore, natyrën e saj punk-rock, dhe vdekshmërinë. Është një kryevepër me tëcilën mund tëndërlidhen shumë vajza "jashtë normave". Kur e lexova për herë të parë librin Indestructible, me tronditi fakti që njëlibër i tillë që flet për vitet e çuditshme të pubertetit, për eksplorimin e trupit tonë; për të rruar apo mos-rruar leshin trupor që tëpërshtatemi; dhe përpërpjekjen që tëqëndrojmë tëvërtete ndaj një kulture misogjeniste, ekziston-te. Cristy ekziston për të na përkujtuar për forcën dhe aftësinë e rinisë; me specifikishtë për rininë punk – për të adresuar tema të tilla sikur përdhunimet, homofobinë dhe misogjininë, Edhe pse, nuk jam punk, nuk i përkasnormës, dhe duke u ballafaquar me identitetin tim, Indestructible na ka dhënë mua dhe shumicës së vajzave tjera të frustruara dhe tëpërbuzura nga moshataret e tyre se janë queer, buç apo punk, njëzë dhe force për te guxuar të jesh ndryshe dhe luftosh!

**nga: Blerta Avdili**

CD REVIEW

## TRUST "JOYLAND"



Albumi i dytë i Trust-it nga Kanada dëshmon të jetë po aq e bukur me këngë emocionale, derisa ju viheni në dyshim nëse doni të pini një shishe verëapo të vallëzoni me zemrën tuaj ose kombinim i të dyjave. Zëri i albumit ju bën të ndjeheni sikur të jeni në një cep të një klubi të errët duke luajtur një video lojë. Vitet 80-të sapo janë përditësuar në vitin 2014. Trust mban ndjenjën e saj për muzikë nga albumi i parë por këtë herëndihet disi më pozitive.TravisEgedy thotë,"unë patjetër mendoj se kjo mund të klasifikohet si muzikë pop,por për mendimet e njerëzve"Më pak i qartë se albumi i parë i Trust-it Joyland ende ka nën ton,ai e di për këtë. Ky album shumë shpejt u bë një nga inxhizimet e mia të preferuar. Më pëlqen sidomos mënyra se si Trust i ka manipuluar vokalet linjat femëror dhe mashkullore duke zhdukur linjat gjinore.

